



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 17 korrik 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Jasmina Zivković, Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje munguan: Shqipe Pantina, Arban Abrashi, Imet Rrahmani dhe Xhevahire Izmaqi.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit: OSBE, INPO, KDI, Kallxo.com dhe RTK2.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizata Joqeveritare**

Komisioni ka shqyrtuar P/ligjin nen për nen dhe ka hartuar propozim - amendamentet si vijon:

Propozim amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.9, fshihet.

Propozim amendamenti 2

Neni 4, paragrafi 3, fshihen fjalët “, me ose pa subjektivitet juridik”, zëvendësohen me fjalën “joqeveritare”.

Propozim amendamenti 3

Neni 10, paragrafi 3, fshihen fjalët “doganor, tatimor, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi”.

Propozim amendamenti 4

Neni 12, paragrafi 3, fshihen fjalët “të arsyeshëm”.

Propozim amendamenti 5

Neni 20, paragrafi 9, pas fjalëve “Statutin dhe” shtohen fjalët “me këtë”.

Propozim amendamenti 6

Neni 22 dhe Neni 25 kanë emërtim të njëjtë, duhet të riemërtohen.

Propozim amendamenti 7

Neni 24, nënparagrafi 1.1, pas fjalës “origjinës” shtohet teksti si në vijim: “, ose me ndonjë dëshmi të vërtetuar në gjykatën e shtetit të prejardhjes;”.

Propozim amendamenti 8

Neni 31, paragrafi 5, nënparagrafi 5.1, fshihet “6”, zëvendësohet me “4”.

Propozim amendamenti 9

Neni 35, paragrafi 2, fshihet “11”, zëvendësohet me “12”.

Propozim amendamenti 10

Neni 35, paragrafi 4, fshihet fjala “pozitive”.

Propozim amendamenti 11

Neni 37, paragrafi 1, fshihen fjalët “rindërtim dhe zhvillim ekonomik” dhe fjalët “zhdukjen e varfërisë”.

Propozim amendamenti 12

Neni 37, paragrafi 2, fshihet fjalia e dytë “Veprimtaria e OJQ-së për zhvillim ekonomik përfshinë veprimtari për të mirën e publikut vetëm nëse ndërmerret në radhë të parë për të mirën e individëve dhe grupeve në kushte të pavoritshme”.

Propozim amendamenti 13

Neni 37, paragrafi 3, fshihet fjala “fillestar” dhe fjalët “ose më vonë”.

Propozim amendamenti 14

Neni 37, paragrafi 4, fshihet “24 dhe 25”, zëvendësohet me “25 dhe 26”.

Propozim amendamenti 15

Neni 37, paragrafi 5, fshihen fjalët “gëzojnë të drejtën për lirim nga tatimi dhe lehtësira tatimore fiskale”, zëvendësohen me fjalët “i nënshtrohen Ligjit për kontrollin dhe menaxhimin e financave publike”. Ky nen duhet të fshihet në tërësi, sepse përmendet legjislacioni në fuqi.

Propozim amendamenti 16

Neni 38, paragrafi 3, shtohet nënparagraf i ri 3.4, si vijon: “raporti i auditorit”.

Propozim amendamenti 17

Neni 38, paragrafi 5, nënparagrafët 5.5 dhe 5.5.1. fshihen në tërësi.

Propozim amendamenti 18

Neni 38, paragrafi 9, fshihet “31”, zëvendësohet me “36”.

Propozim amendamenti 19

Neni 39, paragrafi 1, fshihet “nenit 39”, zëvendësohet me “nenit 38”.

Propozim amendamenti 20

Neni 39, paragrafi 3, fshihen fjalët “tatimore dhe doganore të papaguara që kanë rrjedhur nga lehtësirat tatimore dhe doganore sipas Statusit për Përfitim Publik”, zëvendësohen me fjalët “sipas legjislacionit në fuqi”. Të rishikohet ky paragraf me paragrafin 3 të nenit 10.

Neni 39, paragrafi 5, për rishikim në mbledhjen e radhës.

Propozim amendamenti 21

Neni 40, për rishikim në mbledhjen e radhës.

Neni 40, paragrafi 6, fshihet.

Propozim amendamenti 22

Neni 41, nën- paragrafi 1.2, fshihet fjala “josolvente”, zëvendësohet me fjalën “joaktive”.

Neni 41, paragrafi 2, për rishikim në mbledhjen e radhës.

Neni 41, paragrafi 7, fshihen fjalët “në këtë ne”, zëvendësohen me fjalët “me këtë nen”.

Propozim amendamenti 23

Neni 45, zhvendoset para “Kapitullit X”.

Propozim amendamenti 24

Neni 46, fshihen fjalët “një vit”, zëvendësohen me “gjashtë (6) muaj”.

Propozim amendamenti 25

Neni 47, paragrafi 2, fshihen fjalët “dy viteve”, zëvendësohen me “një (1) viti”.

Neni 47, paragrafi 3, të rishikohet në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani